



Udhëzues për lirim nga provimet

Të gjithë kandidatët, varësisht të asaj se në cilin fakultet kanë përfunduar studimet themelore, me rastin e regjistrimit në nivelin “Teknik i Kontabilitetit” e fitojnë të drejtën për të aplikuar për lirim nga provimet.

Rasti i parë: Lirim nga provimi F1-Kontabilisti në Biznes

Nëse keni kualifikim universitar në ekonomik apo jeni në proces, në të gjitha institucionet e akredituara nga MASHT-i, që të ju mundësohet aplikimi për lirim nga provimi F1-Kontabilisti në biznes ju duhet të dorëzoni si dëshmi:

- Certifikatën e notave origjinale (e nënshkruar dhe e vulosur nga institucioni përkatës)

Provimet relevante me F1-Kontabilisti në Biznes janë:

- i** Hyrje në Biznes,
- i** Bazat e Biznesit,
- i** Kontabilitet,
- i** Hyrje në Ekonomi,
- i** Menaxhmenti,
- i** Sjellja Organizative,
- i** Ndërmarrësia dhe NVM-të,
- i** Menaxhimi Strategjik,
- i** Menaxhimi i Projekteve.

Certifikata duhet të dorëzohet në Zyrën Administrative (në gjuhën shqipe apo gjuhën angleze) të Institutit AAB.

Ndërsa, kërkesën për lirim nga provimet, kandidati/ja e plotëson me rastin e regjistrimit dhe e njejta i bashkangjitet aplikacionit për regjistrim.



INSTITUTI AAB
PËR KONTABILIST DHE AUDITOR TË CERTIFIKUAR

www.institutiaab.org

Të gjitha informacionet e dhëna në aplikacion dhe në kërkesë do të verifikohen dhe më pas aplikuesit do të njoftohen nëse janë të liruar apo jo nga ky provim.

Rasti i dytë: Provimet e tjera të përfunduara në shoqata të licensuara

Nëse keni përfunduar provime në ndonjërin prej shoqatave të licensuara në Kosovë apo në ACCA ju mund të aplikoni për lirim nga ato provime.

